Koment

Per penalitetet e mosdeklarimit te punonjesve

Nisur nga shfuqizimi qe Gjykata Kushtetuse eshte shprehur per disa dispozita ligjore te ligjit te fundit te procedurave, po parashtrojme si fillim, per koment nenin 119, te ligjit nr. 10415 date 07.04.2011, per penalitetet ne lidhje me mosdeklarimin e punobjesve.

Duke qene se dispozita ligjore, "Per Mosdeklarimin e Punonjesve", ka ndryshuar si me poshte:

1.Me ligjin 10415 date 07.04.2011, gjoba u vendos 100.000 leke per biznesin e madh dhe 50.000 leke per biznesin e vogel;

2.Me ligjin 124/2012 date 20.12.2012, gjoba u vendos 500.000 leke per biznesin e madh dhe 250.000 leke per biznesin e vogel;

3.Me ligjin 99/2015 date 23.09.2015, gjoba u vendos 500.000 leke per te gjitha bizneset. Dispozita ligjore ne fjale e ketij ligji, u shfuqizua me Vendim te Gjykates Kushtetuese,

po pashtrojme komentin tone:

Teorikisht rezulton qe, me shfuqizimin e ligjit nr. 99/2015 date 23.09.2015, nga Vendimi i Gjykates Kushtetuese, per dispoziten ligjore te "Mosdeklarimit te Punonjsve", te mbetet ne fuqi ligji 124/2012 date 20.12.2012, ku gjoba per mosdeklarimin e punonjesve percaktohet 500.000 leke per biznesin e madh dhe 250.000 leke per biznesin e vogel, por, por, me kete shfuqizim, i takon te fitoje vetem biznesi i vogel pasi per biznesin e vogel, gjoba, nga 500.000 leke behet 250.000 leke, ndersa per biznesin e madh, gjoba, ishte 500.000 leke dhe mbetet perseri 500.000 leke.

Ne rast se do arsyetonim se gjoba, per shumen prej 500.000 leke, do te ishte nje gjobe shume e larte dhe u shfuqizua, rrjedhimisht per kete problem, gjoba nuk duhet te ekzistoje fare, gje qe sigurisht nuk shkon.

E analizuar ne nje kontekst me te thjeshte :

Gjoba ishte 500.000 leke, u vendos 500.000 leke, u shuqizua, per shumen prej 500.000 leke dhe mbeti 500.000 leke. Nisur nga kjo rrjedhoje kronologjike, na lind mendimi per ta konsideruar kete ecuri te kasaj dispozite ligjore, si nje Rebus.

Me poshte po paraqesim kete dispozite ligjore, te ndryshuar ne menyre kronologjike.

Cdo mendim tuajin do ta mireprisnim me kenaqesi.

Sinqerisht
Luan Gosnishti
Ekspert Kontabel i Regjistruar

LIGJ Nr.10 415, datë 7.4.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Neni 9 Neni 119 ndryshohet si më poshtë:
"Neni 119 **Mosdeklarimi i punonjësve**

1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh;

b) tatimpaguesit e tjerë, gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

2. Për rastet e konstatuara nga zyra të shkeljes së afatit të deklarimit të punonjësve, sipas pikës 1 të këtij neni, tatimpaguesi dënohet me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo deklaratë të padorëzuar apo të dorëzuar jashtë afatit.

3. Tatimpaguesi duhet të deklarojë në organin tatimor të larguarit nga puna brenda 10 ditëve nga data e largimit. Për shkeljen e këtij afati, detyrimet vlerësohen deri në datën e deklarimit të tyre në organet tatimore.".

LIGJ Nr. 124/2012 Date 20.12.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Neni 5

Në nenin 119 "Mosdeklarimi i punonjësve", në pikën 1, shkronjat "a" dhe "b" ndryshohen si më poshtë:

"a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh;

b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh."

Ligji 99/2015 datë 23.09.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Neni 14 Neni 119 ndryshohet si më poshtë:
"Neni 119 **Mosdeklarimi i punonjësve**

1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shënde-tësore, të llogaritura nga data e konstatimit, **dënohet me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh.**

2. Çdo konstatim i përsëritur i mosdeklarimit të punonjësve, pas aplikimit të dënimit administrativ, si në pikën 1, të këtij neni, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 të ligjit dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke bërë kallëzimin penal për tatimpaguesin.”.

NJOFTIM PËR MEDIAN

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
në datën 03.03.2016 shqyrtoi çështjen me palë:

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e neneve 5, 14, 15, 16/4, 17/1, 17/2, 18/ 2 dhe 20 të ligjit nr.99/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

---